

Leksioni 10

PERIUDHAT ME FJALI TË BASHKËRENDITURA

1. Kuptimi i përgjithshëm për frazat me përbërës-fjali të bashkërenditura.

Quhen kështu ato periudha, përbërësit - fjali të të cilave lidhen me lidhëza bashkërenditëse.

Natyrisht lidhëzat janë shprehëse kryesore të marrëdhënieve që vendosen në fjali, por ato mund të dalin edhe pa lidhëza, duke shprehur marrëdhënie bashkërenditëse, duke përdorur mjete të tjera, si :

- bashkëlidhja e trajtave të mënyrave dhe të kohëve të foljes
- paralelizmi strukturor i pjesëve,
- përdorimi i disa ndajfoljeve dhe përemrave në pjesën e dytë,
- rendi, që tek periudhat me fjali të bashkërenditura është i ngulitur e nuk mund të ndryshohet.

Disa periudha me fjali të bashkërenditura kanë strukturë të mbyllur dykryegjymtyrëshe e nuk mund t'u shtohet një pjesë tjetër. Disa të tjera kanë strukturë të hapur, pra, kanë më shumë se dy pjesë, ndaj mund t'u shtohen edhe të tjera.

Periudhat me fjali të bashkërenditura karakterizohen nga raportet e barazisë midis përbërësve, ose fjalive, për shembull :

Mos shiko se ç' thotë, // po shiko ç' bën në botë.

(Të dy çiftet e periudhave janë në raporte barazie e vihen në marrëdhënie bashkërenditëse kundërshtore midis tyre).

Po këto raporte e marrëdhënie shprehen edhe tek shembulli me ndërtim jolidhëzor:

Desha mos ma marri vesh burri, // ma mori vesh gjithë katundi.

(Krahaso: //, por ma mori vesh gjithë katundi)

Barku mban një tok të liga, // goja s' mban një fjalë.

Nata i ka veshët,// dita i ka sytë.

Në behar mos harro gunën,// në dimër mos harro bukën.

Goja tret male,//fjala rrëzon krale.

Gjuha flet e fshihet,//shpina pret e rrihet.

2. Llojet e frazave me përbërës-fjali të bashkërenditura:

Këto lloje zakonisht ndahem duke u bazuar në mjetet e lidhjes sintaksore, përndryshe lidhëzat bashkërenditëse, por edhe nga kuptimi, kur përbërësit-fjali lidhen pa lidhëza, ose në mënyrë asindete. Grupet janë këto:

- a. Periudha me përbërës-fjali të bashkërenditura *shtuese* (këpujore)- përbërësit e të cilave lidhen me lidhëzat bashkërenditëse : *e, dhe, edhe, as*; dhe me lidhëza të përsëritura: *edhe...edhe, as...as, jo vetëm që...por edhe, jo vetëm që...por as* etj., për shembull:

Bie një fjalë e nxjerr njëmijë.

Buka do pjekë e fjala do matë.

As mos u ngut, as mos u tut.

Në periudha të tilla kumtohen veprime e ngjarje që ndjekin njëra-tjetrën, me raporte kohore të ndryshme (njëkohësi, parakohësi, paskohësi) midis fjalive përbërëse, të cilat vihen në marrëdhënie numërimi, marrëdhënie shkak – pasoje, kundërshtie dhe marrëdhënie shkallëzimi, bie fjala :

Hëna nxori syrin mbi mal dhe pylli mori një dritë të zbehtë.

Treni u ndal dhe platforma e stacionit u mbush me udhëtarë.

Frynte një puhizë dhe valëzimi në det po shtohej.

Kanë kaluar shekuj dhe kjo ka qenë një provë e madhe për gjuhën shqipe të shkruar.

Festivali i Vranjes jo vetëm që la mbresa të mëdha, por edhe solli mjaft risi artistike.

Le të lavdërojë tjetërkush e jo goja jote.

- b. Periudha me përbërës-fjali të bashkërenditura **veçuese** - përbërësit e të cilave lidhen me lidhëza bashkërenditëse veçuese: *ose, o, apo, a*; apo edhe të përsëritura: *ose...ose; o...o; ja...ja; ndo...ndo, daç ... daç*. Në këto periudha jepen dy dukuri a fakte që përjashtojnë njëri-tjetrin, domethënë që njëri nga faktet realizohet, kurse tjetri përjashtohet. Ka strukturë të hapur të karakterizuar nga paralelizmi strukturor i pjesëve përbërëse, për shembull:

Do të vini me ne, apo keni plan tjetër.

Mund të jenë vonuar, a mund ta kenë lënë nisjen për nesër.

O fol për të qenë, o hesht e mos nxirr zënë.

O duro e plas, o fol e del për gaz.

O Kazi, o Kazi, a s'do, a s'di ?

Në këto periudha fjalitë ndahen me presje kur lidhen me lidhëza të përsëritura.

- c. Periudha me përbërës-fjali të bashkërenditura **kundërshtuese** : - në të cilat përbërësit kallëzuesorë (predikativë), lidhen me lidhëza bashkërenditëse kundërshtuese: *po, por, porse, kurse, mirëpo, ndërsa, veç, vetëm, vetëm se*; karakteristikë e të cilave është ndërtimi dygjymtyrësh dhe paralelizmi i gjymtyrëve. Në këto fjali shprehen veprime, situata apo ngjarje që kundërshtojnë njëra tjetrën, p.sh.:

Kam fjetë jashtë, por mendtë i kam pasë mbrendë.

Dasma do dajre, kurse mortja do vaj.

Çdo gjë ka gjetur karar, vetëm mjekrës së qoses nuk i është gjetur.

Kali dridhet sa dridhet, po në strumbullart mblidhet.

Lule shumë çilin, por pak kokrra lidhin.

Detyra e çdo burri është të njohë kufijtë e nderit, ndërsa nderi i çdo

detyre kapërcen kufijtë e frikës së burrit.

Struktura e këtyre fjalive është e mbyllur, vetëm me dy gjymtyrë. Këto marrëdhënie bashkërenditëse kundërshtore shprehen edhe në rastin e ndërtimeve asindete (jolidhëzore), fjala vjen :

Buza qesh e syri qan, // zemra bën durim e mban. (kurse, porse, vetëm, por).

d. Periudha me fjali të bashkërenditura *përmbyllëse*: - në të cilat përbërësit kallëzuesorë lidhen me lidhëza bashkërenditëse përmbyllëse *andaj, prandaj, pra, pa*. Në këto periudha fjalia e dytë është përmbyllje, përfundim i asaj që thuhet në pjesën e parë. Struktura është detyrimisht dykryegjymtyrëshe, p.sh.:

U dogj plaka kungujsh, pa i fryn dhe kosit.

Kryet shëndosh, pra kësula gjen sa të duash.

Duhet ta kesh zanat, pa të vesh hoxhë në fshat.

Marrëdhënie bashkërenditëse përmbyllëse mund të shprehen edhe pa lidhëza, si në çiftet e këtyre periudhave, b.f.:

Fort kërkove, prapa mbete; mendtë e tua s'mund i gjete (prandaj).

Ushtrimi 1: *Dalloni në këtë tekst bashkimet e ndryshme me bashkërenditje:*

Ashtu siç pritej, lajmi se mbi Ujanën e Keqe do të ndërtohej një urë, u përhap shpejt. Ura qenë ndërtuar herë pas here gjithandej, por s'mbahej mend që ndonjëra prej tyre të kishte bërë kaq bujë. Ishin ndërtuar pothuajse heshturazi, me një zhurmë të vazhdueshme çekiçësh, në dru, që pak ndryshonte nga monotonia e kuakjes së bretkosave aty pranë. Pastaj, pas mbarimit, kishin shërbyer po kaq heshturazi, gjersa ishin rrëmbyer ndonjë ditë nga ujërat e turbullta, ose ishin djegur, nga vetëtimja, ose, edhe më keq akoma, ishin katandisur në atë gjendje, saqë udhëtari, pasi kishte hedhur hapin e parë mbi dhogat e tyre të kalbëta, kishte qëndruar në mëdyshje për hapin e dytë, pastaj qe kthyer mbrapsht, për të kërkuar diku afër ndonjë trap apo ndonjë vah, që të hidhte lumin. Dhe kjo ndodhte kështu, sepse të gjitha ato kishin qenë ura të drunjta, kurse kjo që do të ngrihej, do të ishte një urë e vërtetë prej guri, me harqe e kalldrëm të fortë sipër, ndoshta e para e këtij lloji në gjithë dheun e Arbrit.

Trapet ishin të pista, të lagështa, dhe prej vërtitjes së tyre të vinte për të vjellë, kurse ajo, ura, do të ishte gjithmonë aty, në çdo orë të ditës e të natës, e gatshme për të shtruar shpinën e saj prej guri nën këmbën tënde, pa u lëkundur e pa bërë naze. S'do të kishin më gajle as nga lumi, që herë fryhej e bënte hatanë e herë hollohej si peri, thua se po hiqte shpirt. Njerëzit ndienin një gëzim që asaj, *Ujanës së Keqe*, që i kishte munduar aq shumë, do t'i vinin më në fund një kllapë guri përsipër. Por tamam kjo gjë, bashkë me gëzimin, edhe i frikësonte. Një mushke xanaxare s'ishte lehtë t'i vije një samar sipër, pale Ujanës së Keqe. Oh, do të shohim, do të shohim si do të vejë puna, thoshin ata.

(I. Kadare, *Ura me tri harqe*, *Vepra letrare* 8, T. 1981, fq. 138-139)

(II.

Detyrë në shtëpi: *Nga një libër letërsie (me autor, titull, vend e vit botimi e faqe), gjeni nga 2 fraza për çdo grup të frazave me përbërës-fjali të bashkërenditura : shtuese, veçuese, kundërshtore dhe përmbyllëse.*

Leksioni 11

PERIUDHAT ME FJALI TË NËNRENDITURA

Çështjet :

1. Kuptimi i përgjithshëm i fjalive të nënrenditura;
2. Mjetet e lidhjes sintaksore në përbërësit e periudhave me nënrenditje;
3. Llojet e fjalive të nënrenditura;
4. Fjalitë e nënrenditura kryefjalore;
5. Fjalitë e nënrenditura kundrinore;
6. Fjalitë e nënrenditura kallëzuesore.

1. Kuptimi i përgjithshëm.

Periudha me fjali të nënrenditur është tërësi sintaksore në unitet kuptimor dhe gramatikor, e formuar së paku prej dy njësisish kallëzuesore në formë fjalie me raporte pabarazie.

Njësia – bazë organizuese e periudhës është quajtur *fjali kryesore*, kurse tjetra *fjali e nënrenditur* ose *e varur* dhe që varet sintaksorisht nga fjalia e parë dhe e plotëson atë. Të dyja së bashku, të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, formojnë fjalinë përbërë si një njësi sintaksore me strukturë dhe me kuptim gramatikor të veçantë.

Për shembull:

Mblidh mendtë, se të ha ujku dhentë.

Kur humba djathin, ç'më duhet hirra.

Kush e nis vallën, di ta heqë vetë.

Le ta dijë gjithsecili, breshka nuk këndon si bilbili. (Marrëdhënie ffilluese, pa lidhëza a fjalë lidhëse).

Pjesa prej së cilës varet një pjesë tjetër quhet drejtuese. Pra, pjesë drejtuese është pjesa kryesore, por mund të jetë edhe një pjesë e nënrenditur, në qoftë se prej saj varet një tjetër, p.sh. :

Disa kishin me vete fëmijët, që mbanin në duar flamurë ose lule artificiale.

Dikush më tregoi si kalohej në tribunën C-1, gjë që e harrova në çast, gjersa një tjetër ma tregoi.

Në fjalinë e përbërë pjesa e nënrenditur mund t'i referohet pjesës kryesore në tërësi, p.sh.:

U kthye nga i shoqi i mbesës, me qëllim që t'i thoshte ndonjë fjalë.

Sa më shumë i largoheshin bregut aq më i shpejtë bëhej turri i anijes në det të hapur.

ose mund t'i referohet një gjymtyre të saj, p.sh :

Mendimi se mund të ktheheshin përsëri, e tmerronte.

Ai që i shoqëronte , ishte i panjohur.

2. Mjetet e lidhjes sintaksore në përbërësit e periudhave me nënrenditje.

Si mjete lidhjeje të fjalive në periudhat me nënrenditje shërbejnë:

- lidhëzat nënrenditëse, lokucionet lidhëzore nënrenditëse dhe fjalët lidhëse
Ngaqë ishte shumë vonë, nuk dukej asnjë dritë,
- fjalët korelative
Kjo është kështu siç ju them unë.
Gjeti punë aty ku s'e priste.
- mungesa e një gjymtyre të domosdoshme në pjesën drejtuese
Kush s'beson le ta provojë.
Ai që punon gëzon.
- bashkërregullimi i trajtave mënyrore e kohore të foljeve
Ç'ke ndër mend të bësh, Loni?
- rendi dhe intonacioni (pauzat midis tyre)
Dhe i shtrëngoi grushtat sa i dhembën noçkat. (kemi folur më parë).

3. Llojet e fjalive të nënrenditura;

Këto periudha klasifikohen në mënyra të ndryshme dhe nisur nga kriteret të ndryshme, ndër të cilat më kryesori është ***paralelizmi funksional*** midis pjesëve të nënrenditura dhe gjymtyrëve të fjalisë së thjeshtë të zgjeruar, por zbatohen edhe parime të tjera. Në traditën tonë gramatikore, sipas paralelizmit funksional, gjejmë këtë grupim të periudhave me fjali të nënrenditura:

- ♂ periudhat me fjali të nënrenditura kryefjalore;
- ♂ periudhat me fjali të nënrenditura kundrinore;
- ♂ periudhat me fjali të nënrenditura kallëzuesore;
- ♂ periudhat me fjali të nënrenditura përcaktore;
- ♂ periudhat me fjali të nënrenditura rrethanore (me disa nënndarje) :
 - *periudha me fjali të varur kohore,*
 - *periudha me fjali të varur vendore,*
 - *periudha me fjali të varur shkakore,*
 - *periudha me fjali të varur qëllimore*
 - *periudha me fjali të varur mënyrore,*
 - *periudha me fjali të varur krahasore,*
 - *periudha me fjali të varur rrjedhimore,*
 - *periudha me fjali të varur kushtore,*
 - *periudha me fjali të varur lejore.*

Këta tipa dallohen nga njëri - tjetri prej *marrëdhënieve që shprehin, funksionit që kryejnë dhe prej mjeteve të lidhjes sintaksore.*

Krahas këtij klasifikimi, periudhat me fjali të nënrenditura mund të jenë:

- *lidhëzore (sindete),*
- *jolidhëzore (asindete).*

Ushtrimi 1: *Dalloni ndërtimet me bashkërenditje dhe ndërtimet me nënrenditje*

Lart, në faqen e një kodre, midis qiparisave hijerëndë, shokët ia mihnin varrin Genthit. Mihnin dhe fshinin lotët me pëllëmbë, ndërsa urrejtja u gurgullonte si ata krojet e shumtë të Drimonës. Pakëz më tej drimonasit hapnin shumë varre për njerëzit e tyre të dashur, që nuk ishin më ndër të gjallët: varre burrash dhe pleqsh, po më shumë varre grash dhe fëmijësh.

Genthi, i zbehtë, pa pikëzën e gjakut në fytyrë, dergjej në vigun e varrimit të vendosur mbi shtrojca lëkurësh ariu, përpara vatrës, në dhomën e madhe, nën vështrimin e ftohtë të perëndive dhe perëndeshave të shumta: atyre të shtëpisë së Asoparëve, atyre të fisit dhe atyre të të gjithë Enkelisë: dru bushi, bungu a qarri ose gurë të fortë Laveshte, të cilët duart e ngathëta të drugdhendësve të moçëm – enkelej e ordenj dhe lynkestë – i kishin latuar në trajta kokash ose shtatoresh pak a shumë të përngjashme me ato të njerëzve. Ata të shtëpisë prisnin të zbrisnin nga mali nëna e tata, që ta përcillnin Genthin në të përtejmen.

Ushtrimi 2: *Dalloni ndërtimet me bashkërenditje dhe ndërtimet me nënrenditje.*

Deri atëherë ne nuk kishim ndier akoma mbi vete të tërë peshën e rëndë të luftës dhe as erën e kufomave të huaja që qelbeshin mbi tokën tonë. Në luftën italo-greke fashistët vendosën një garnizon edhe në Lug. Ata zunë shtëpitë tona më të mira. Oficerët dilnin mbrëmjeve nëpër hajate, pinin aranxhata me fërnet që i ftohnin në ujin e gurrës dhe luanin letra me cigaret e ngjitura në buzë. Në mëngjes ushtarët laheshin nëpër sylinjarët pasi kalonin mes për mes fshatit gjysmë të zhveshur. Ata këndonin gjithsekush në kokë të tij dhe dukej sikur kishin ardhur për të pushuar në këto male, për të thëthitur ajër të freskët.

(F. Ballanca, Nomeja e largët, 1989, fq. 174, 175)

4. PERIUDHA ME FJALI TË VARUR KRYEFJALORE.

Këto periudha, së bashku me ato kundrinore, quhen ndryshe edhe periudha me *fjali të varura filluese* (kryefjalore e kundrinore), sepse ato plotësojnë a sqarojnë një gjymtyrë të fjalive drejtuese, p.sh.:

Kush ka gjetur vahun, s'ka pse pyet për urën.

Kush s'hap sytë, hap qesen.

Përherë kam dëshirë ta dëgjoj atë këngë.

Çka të ban goja, s'ta ban anmiku.

Periudhë me fjali të varur kryefjalore quhet ajo periudhë me një fjali të varur që kryen ndaj fjalisë kryesore një funksion të ngjashëm me atë të një kryefjale të një fjalie dykryegjymtyrëshe. Në periudha me fjali *kryefjalore*, fjalia e varur u përgjigjet pyetjeve: *ç'?* *çfarë?* *ç'gjë?* *kush?* P.sh.:

Është e çuditshme si mbajti kjo verë sivjet.

Kush flet pa menduar, mbetet i turpëruar.

I dukej sikur të gjithë i kishin sytë tek ai.

Fjalia kryefjalore ka dy tipa strukturorë sipas mjetit të lidhjes me fjalinë drejtuese :

- a. Fjalinë kryefjalore lidhëzore me lidhëzat filluese *se, që,* me lidhëzat *kushtore sikur, në, nëse, po;* me lidhëzën kohore *kur;* me lidhëzën *si,* me pjesëzat e pyetjes *a, mos.* P.sh. :

Ishte e qartë që atyre s'u kish rënë në sy një gjë e tillë.

I dukej sikur i gjithë pazari i Korçës i kishte sytë e veshët tek ai.

- b. Fjalinë kryefjalore përemërore me përemra e ndajfolje pyetëse dhe përemra të pacaktuar lidhorë, si : *kush, ç, çfarë, se (me se, nga se), sa, i sati, ku, nga, që ku, gjer ku, si (qysh), përse, pse, gjithë sa, gjithë ç, gjithë çka, tërë sa :*

Kush mëson në djalëri nuk gjen nder në pleqëri.

Ç'erdh njëherë, s'vjen përherë.

Në periudhat me fjali të varur *kryefjalore*, kallëzuesi i fjalisë drejtuese mund të jetë:

- folje kalimtare joveprore në vetën e 3^{-të} njëjës, si: *flitet, dëgjohet, kërkohet, ndalohet, duket, thuhet* etj.

Na është ndaluar të quajmë një sharrë të vogël “sharrëzë”, sepse me këtë emër quajmë një farë sëmundjeje të fytit.

Asaj i pëlqente t'i vinte veshin fjalëve të tij.

- folje veprore, si: *ka kuptim, s'prish punë;*

S'ka kuptim të bëhet trajtim tjetër i sëmundjes.

- folje jokalimtare, si: *thuhet, flitet, ngjan, ndodh, qëllon, rastis;*

Ndër studentë flitet se do të shkojmë në Kolashin.

5. PERIUDHA ME FJALI TË VARUR KUNDRINORE.

Periudhë me fjali të varur kundrinore quhet ajo periudhë me një fjali të varur e cila drejtpërdrejt apo tërthorazi kryen ndaj fjalisë kryesore një funksion të ngjashëm me atë të një kundrine. Në periudha me fjali *kundrinore*, fjalia e varur u përgjigjet pyetjeve: *ç'?* *çfarë?* *për çfarë?* etj. Për shembull:

Lojtarët folën të bindur se do të fitonin.

Desdemona nuk e dinte që kishin për të shkuar aq larg.

Fjalitë e varura kundrinore bashkohen me kryesoren :

1. Me lidhëza ffilluese të mirëfillta *se, që* :,

Rrëfejnë se në atë vit u bë një i ftohtë i tmerrshëm.

2. Lidhen drejtpërsëdrejti, kur kallëzuesi i fjalisë së varur është në mënyrën lidhore. Lidhëza ffilluese *që* mund të mos përdoret kur fjalia e nënrenditur nis me foljen – kallëzues në mënyrën lidhore dhe atëherë, mjet i lidhjes sintaksore midis përbërësve kallëzuesorë është pjesëza *të* e kësaj mënyre. Në raste të tjera lidhëza del e domosdoshme, për shembull:

Më tepër i pëlqente të dëgjonte zërin e dashur të gjyshes.

Lojtarët e kombëtares sonë synojnë të arrijnë një rezultat të kënaqshëm në ndeshjen me Danimarkën.

Deshi të thoshte diçka.

3. Me përemra lidhorë të pacaktuar :

Merr kë ke për të marrë e nisu.

Ç'të zuri gjuha, Tine zemra e kurrë të mos e qasë

4. Me përemra e ndajfolje pyetëse, si dhe me pjesëza të paraprirë herë – herë nga lidhëza ffilluese:

Dëgjo, ç'më ndodhi.

E di, e di kush ma ka fajin mua.

Ne e dimin përse luftonim.

U mundua të kujtonte nëse e kishte mbyllur derën.

Ajo u ul aty afër për të parë se ç'rrezik po u kanosej fëmijëve të saj.

E merrni me mend se sa keq më erdhi.

Në periudhat me fjali të varura **kundrinore**, folja-kallëzues e fjalive drejtuese është përherë në trajtën veprorë, në tri vetat, njëjës e shumës; për shembull:

Dihet se njerëzit luftojnë për të mos vdekur.

Pas asaj ngjarjeje thonë që aksidenti nuk ishte i qëllimshëm.

Në periudha të tilla fjalia e nënrenditur qëndron pas fjalisë drejtuese, por sipas qëllimit të thënies e situatës ligjërimore, sidomos, kur duam ta theksojmë atë, fjalia e varur vendoset përpara fjalisë drejtuese, p.sh.:

Ç'the me gojë, e ndjen me veshë.

Çka ta ban goja, s'ta ban anmiku.

6. PERIUDHA ME FJALI TË VARUR KALLËZUESORE.

Periudhë me fjali të varur kallëzuesore quhet periudha me një fjali të varur që kryen funksionin e pjesës emërore të kallëzuesit emëror ose funksionin e përcaktorit kallëzuesor.

Kësaj radhe ishte Agroni që shikoi drejtorin.

Plaku i shtir sikur nuk dëgjoji gjë.

Fjalja e varur kallëzuesore bashkohet me fjalinë kryesore (drejtuese)

- me lidhëzat *se, që, sikur, kur, tek* :

Çudia që se kjo lagje kishte vetëm dy shtëpi.

Shqetësimet i dukej sikur ishin me vend.

- Drejtpërdrejt, kur kallëzuesin e ka në mënyrën lidhore :

Puna e parë që duhej bërë që të ndizej zjarri

- Me përemra të pacaktuar, me përemra lidhorë dhe me ndajfolje lidhore :

Ç'është ushqimi për trupin, është leximi për mendjen.

Ishte pikërisht kjo që e gëzonte më shumë.

Erdhi nga s'ta pret mendja.

Ai është siç ka qenë.

Siç ka qenë ashtu është edhe tani.

Në fjalinë kryesore mund të ketë edhe fjalë të bashkëlidhura (korrelative), të domosdoshme ose jo, si ndajfoljet dëftore *ashtu, kështu, njësoj*.

E gjetëm ashtu siç e kishim lënë.

Ishte kështu siç të thashë

Dallohen disa tipa semantiko - strukturorë periudhash me fjali të varura kallëzuesore :

- a. Tipi lidhëzor jokorrelativ me lidhëzën *sikur*, pa ndonjë korrelatë të kryesorja, përdoret pranë foljeve me kuptim të caktuar të fjalja kryesore :

Shqetësimet i dukeshin sikur ishin me vend

Sa për të tjerat i quaj sikur i kam marrë plotësisht.

- b. Në tipin përemëror jokorrelativ fjalia e varur bashkohet me kryesoren kryesisht me përemrat ç dhe ç'ka, duke shprehur përshtatshmëri tiparesh, me përemrat lidhorë që, i cili,

Ai të shembte në dru, të ishte ç'të doje.

Të tillë tituj a fjalë, që shohim sipër dyqaneve, janë për analizën logjike ç'ka janë epifonemat dhe pasthirrmat për analizën gramatikore.

Janë dosjet që flasin

Ishte ideali i tyre, që i afronte këta aq shumë.

Je ti që martohesh, moj Mirë !

- c. Në tipin ndajfoljor fjalia e varur bashkohet me kryesoren me anë të ndajfoljes lidhore si, së cilës mund t'i përgjigjen në fjalinë kryesore si korrelatë ndajfoljet dëftore ashtu, kështu :

Kur të bëhesh ti sa unë, nuk do të jesh si je.

Si jam unë, qofsh edhe ti.

S'është puna ashtu si thua ti.

Ushtrimi 3: *Dalloni dhe analizoni periudhat me fjali të nënrenditura kryefjalore e kundrinore, duke shpjeguar mjetet e lidhjes dhe rendin sintaksor:*

Evrenozi nuk e kuptonte dot turbullimin e thellë që i shkaktonte prania e këtij njeriu. I vinte sikur i ngjallej në bark një kafshë e vogël e tmerrshme. Pastaj e kuptoi. Iu bë se ia kishte parë fytyrën në Berat. Dy vjet më parë, atë mbrëmje kur ra më gjunjë të falej për fitoren, ai ndjeu se fati do ta çonte edhe një herë përballë Skënderbeut, që i shpëtoi nëpër duar. Gjatë dy vjetëve kjo ndjenjë e pushtonte herë pas here. I bëhej sikur Skënderbeu ia kishte caktuar orën dhe e linte përkohësisht të lirë të bënte ca marrëzira. Tani ky njeriu i Beratit i rrinte në krah dhe ishte shkaktar i fushatës, nga e cila sulltani kërkonte përmbysjen e Shqipërisë. Po Skënderbeu ishte zhdukur dhe nuk mbetej asgjë për t'u përmbysur.

Ushtria turke prej pesëdhjetë mijë vetësh doli në fushë të hapët dhe ndjeu erën e detit. Njëzet mijë të tjerë mbronin rrugën prapa dhe mbanin të rrethuar kalanë e Çidhnës në Dibër dhe atë të Gurit të Bardhë në Mat.

Fusha pranë detit ishte po aq e shkretë sa malet prapa.

“Këtu duhet pritur ai, mendoi Evrenozi, “megjithëse kjo nuk përshtatet me zakonet e tij”.

Evrenozi lëshoi përpara Hamzanë me kalorësinë. Ky i ra vendit qark. Shkoi deri afër Krujës në lumin Dro, zbriti në Kashar, në Vorë, u kthye drejt kepit të Rodonit dhe arriti nën muret e Lezhës. Plaçkiti e dogji dhe vuri në tortura pleqtë dhe gratë e cilindo që gjeti. Asnjeri nuk dinte gjë të re për Skënderbeun dhe thoshin të njëjtën gjë: *“Ungji yt ka kaluar në tokën e Venedikut”*. Ai u kthye te Evrenozi, i bindur se Skënderbeu mund të ishte kudo, po jo në hapësirën ndërmjet Krujës, Durrësit dhe

Lezhës. Asnjë dredhi njerëzore, asnjë lëvizje natën ose pas krahëve s' mund ta kishte mashtruar Hamzanë.

Evrenozi e shikonte në sy dhe e aprovonte me kokë.

(S. Godo, Skënderbeu, T. 1975, fq. 259)

Ushtrim krijues: *Ktheni fjalitë e thjeshta në fjali të përbëra, në atë mënyrë që kryefjalët dhe kundrinorët e tyre të kthehen përkatësisht në fjali kryefjalore e kundrinore; tregoni rendin e tyre dhe shpjegoni me ç'mjete lidhen:*

Nuk dinte gjë për ardhjen e lajmëtarit nga Sfetigradi. Këto vitet e fundit vihet re nxjerrja e shumë gazetave të pavarura. Që në mëngjes ndihej shpërthimi i shtrëngatës. Nuk pritej rënia e dëborës që në tetor. Tani shihet më mirë gjallërimi natyrës në prag pranvere. E kemi pritur me padurim daljen e këtij libri. Kjo kërkon zgjidhjen e shpejtë të problemit.

Modeli:

*Nuk parashikohej **ardhja** e rrezikut nga ajo anë.*

*Nuk parashikohej (ç'?) **që të vinte rreziku nga ajo anë.***

Tani e pamë përfundimin e rrugës së re Durrës-Prishtinë.

*Tani e pamë (çfarë?) **se përfundoi rruga e re Durrës-Prishtinë.***

Ushtrim krijues: *Formoni periudha me fjali kryefjalore dhe kundrinore, duke përdorur mjetet e mëposhtme të lidhjes sintaksore:*

- a. lidhëzat : *sikur, në, nëse;*
- b. përemrat pyetës : *cili, me se, sa;*
- c. përemrat lidhorë : *ç'. gjithsa, gjithë ç'.*

Provoni t'u ndërroni vendin përbërësve (fjalive) sipas qëllimit të kumtimit dhe theksimit.

Ushtrim krijues: *Fjalitë pyetëse të thjeshta shndërroni në fjali të nënrenditura, së pari, kryefjalore, pastaj në kundrinore, brenda një periudhe, sipas modelit të dhënë dhe shpjegoni rendin e mjetin e lidhjes sintaksore:*

Ç'ë kishte sjellë në atë orë të vonë, vallë?

Sa shikues ishin ulur në shkallët e stadiumit të lojërave me dorë?

Ku do shkonin pas ndeshjes?

Kishte shumë stenda në panairin e librit?

A foli në promovim Ismail Kadareja?

Modeli:

Kush e fitoi Festivalin Europian këtë vit ?

1. Nuk dihet kush e fitoi Festivalin Europian këtë vit.
2. Nuk e dimë kush e fitoi Festivalin Europian këtë vit.